



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS NË FUSHË KOSOVË

Numri i lëndës: 2022:221126
Datë: 29.09.2023
Numri i dokumentit: 04738067

PPP. nr. 940/22

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit S. G nga, komuna e Obiliqit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xh. K, avokat në Prishtinë, kundër debitorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e datës 21.10.2022, të ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit me numër P.nr.262/2022, të datës 13.10.2022, të lejuar nga përmbaruesi privat E. M, jashtë seancës, me datë 29.09.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit me numër P.nr.262/2022, të datës 13.10.2022, të lejuar nga përmbaruesi privat E. M në Prishtinë.

II. Mbetet në fuqi urdhri përmbarimor P.nr.262/2022, i datës 13.10.2022, i Përmbaruesit Privat E. M.

A r s y e t i m

Përmbaruesi privat E. M në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër C.nr.2990/07, të datës 30.10.2018, i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit CA.nr.573/19, të datës 04.07.2022, me të cilin ka kërkuar që debitori të obligohet që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrit, në emër të kompensimit për tokën e shpronësuar, t'i paguaj kreditorit shumën prej 13,875.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim. I njëjti ka theksuar se propozimi për përmbarim ka të meta substanciale për arsye se as pala personalisht, por as i autorizuari i tij nuk kanë parashtruar kërkesë për ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm, dhe se debitori nuk ka pasur llogari bankare qoftë të palës apo të përfaqësuesit të saj për kryerjen e pagesës, e duke shtuar se këto procedura janë standarde.

Brenda afatit ligjor përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori përmes të autorizuarit të tij, në të cilin ka theksuar se si palë kreditore nuk kanë paraqitur kërkesë te debitori për përmbushjen e aktgjykimit sepse kreditori nuk ka nevojë që në procedurë administrative të paraqes kërkesë për përmbushje, por që kjo procedurë rregullohet me Ligjin për Procedurën Përmbarimore.

Gjykata ka vlerësuar se përmbarimi i lejuar nga ana e Përmbaruesit Privat bazohet në dokumentin përmbarimor - aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, CN.nr.2990/07 të datës 30.10.2018, i plotfuqishëm me datë 03.03.2020 dhe i ekzekutueshëm me datë 04.07.2022, në bazë të të cilit organi përmbarues edhe e ka zbatuar përmbarimin. Sipas vlerësimit të Gjykatës, Aktgjykimi në fjalë është dokument përmbarues, i ekzekutueshëm dhe përbën bazë të ligjshme juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i njëjti i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 24 paragrafi 1 i LPK-së i cili ka përcaktuar se *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”*, si dhe neni 27 paragrafi 1 i LPP-së i cili ka përcaktuar se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata e shqyrtoi prapësimin e debitorit, mirëpo gjeti se debitori nuk ka ofruar asnjë provë për të argumentuar pretendimet e veta në të cilat thirret në prapësim. Pretendimet e debitorit se propozimi për përmbarim nuk mund të pranohet pasi që Avokatura Shtetërore si përfaqësuese ligjore e ka pranuar aktgjykimin C.nr. 2990/07 dhe të njëjtin e ka përcjellë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - organi shpronësues, pasi që e njëjta bënë kompensimin e paluajtshmerive të shpronësuar, megjithatë debitori nuk ka mundur ta bëjë pagesën derisa në Departamentin e Shpronësimit nuk paraqitet propozuesi-këtu kreditori, apo përfaqësuesi i tij me autorizim dhe derisa nuk e ka njoftuar debitorin me llogarinë bankare se ku duhet të barten mjetet, janë të paqëndrueshme.

Gjykata gjen se debitori që nga pranimi i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, me të cilën është bërë e kërkueshme kredia e kreditorit, ka pasur afatin partitiv për të paguar detyrimin dhe fakti se aktgjykimi tani është i plotfuqishëm e bën të njëjtin dokument të përshtatshëm për përmbarim. Për më tepër, e paditura – këtu debitore si palë në procedurën të zhvilluar në gjykatë, i ka pasur në disponim të gjitha shkresat e lëndës, përfshirë edhe adresën e kreditorit dhe të autorizuarit të tij, për ti kontaktuar lidhur me përmbushjen vullnetare të vendimit të gjykatës.

Gjykata gjen se, duke u nisur nga fakti se në rastin konkret urdhri për përmbarim bazohet mbi një dokument përmbarimor të përshtatshëm për përmbarim dhe të plotfuqishëm, ajo është e lidhur dhe shqyrton rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues. Andaj, Gjykata

rithekson se në procedurën e përmbarimit duke vendosur sipas prapësimit është e kufizuar vetëm në ekzistimin e ndonjërit nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, në të cilat bazohet prapësimi i palës.

Andaj, nga arsyet e paraqitura, gjykata vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit e të cilat janë parapara me nenin 71 të LPP-së. Së këndejmi, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe të njëjtin e refuzoi në tersi si të pabazuar.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil

PPP.nr.940/22, më datë 29.09.2023

Gjyqtarja
Qëndresa Beqiri Murati

KËSHILLË JURIDIKE: *Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.*